



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 340/14 prot.

Pogradec, më 26.02 2026

VENDIM

Nr. 21, DATË 25/02 /2026

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 12.2200 HA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE BUÇIMAS QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1.Të miratojë listën e sipërfaqes së tokës bujqësore prej 12 Ha (Dymbëdhjete hektar) dhe 2200 m² (dymije e dyqind metra),të ndodhur në Njësinë Administrative Buçimas, që mund të jepen me qera sipas listës.

Nr	Pronësia	Z K	Nr Pasurisë	Vol	Faqe	Vëndodhja	Sip m2	Lloji
1	Shtet	3745	324	6	92	Vërdovë, Buçimas	122200	Arë
TOTALI							122200	

- 2.Toka Bujqësore që do të jepet me qera do te shfrytëzohet vetëm për veprimtari bujqësore dhe te tjera veprimtari ne funksion te saj.
- 3.Afati i dhënies me qera do të jetë në përputhje me destinacionin e kultivimit por asnjëherë më i gjatë se afati i përcaktuar pikën IV të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".
- 4.Çmimi dysheme i vlerës së qerasë nuk do te jete jo më pak se 6000 (gjashtëmije) lekë Ha në vit sipas pikës nr 10 të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".
- 5.Per zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Bordi qeradhenies tokes bujqesore , si dhe Njësia Administrative Buçimas.
- 6.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLI
Manjola KAMOLLI

7. 1.Miratuar me 18 vota
8. 2.Vota Pro 18
9. 3.Vota Kundër 2
10. 4.Vota Abstenim 2
11. 5.Zbardhur më date 25.02.2026

